

**AKT- THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ANG-OLI” sh.p.k**

Në Durrës, sot më datë 15 Tetor 2024.

Ortaku i vetëm themelues:

**Z. Angelo Oliva**, I biri I Nicola-s dhe I Liboria-s, lindur në Sesto San Giovanni Itali, dhe banues në Itali, Milano, Rrg.San Pietro, Nr.1, Komuna Barzana, nënshtetas Italian, identifikuar nepermjet Kartes se Identitetit me Nr.CA27600LD, me zotësi juridike të plotë për të vepruar, me cilësinë e “Ortakut të vetëm themelues” kërkoi redaktimin e këtij akti themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroi se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqërite tregëtare”, ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, në atë Doganor, Fiskal Tatimor, krijon shoqërinë tregëtare, me përgjegjësi të kufizuar, “ANG-OLI” Sh.p.k

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

**“ANG-OLI” sh.p.k**

Është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj Shoqëria “ANG-OLI” sh.p.k, është një shoqëri tregëtare, e themeluar nga **Z. Angelo Oliva**, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregëtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në: Shkallnur, Njesia Administrative Rrashbull, Njësi me Nr.Pasurie 578/355/ND+1-11/2, ZK.3385, Durrës. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e Ortakut themelues.

**Neni 4**



## **Objekti i veprimtarisë**

Konsulencë në sektorin e Energjisë, Telekomunikacionit dhe Shërbimeve, për subjekte Fizik dhe Juridike sipas kërkesave etj.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## **KREU II**

### **Kapitali**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë, i nënshkruar plotësisht nga ortaku i vetëm themelues në masën 100%. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta). Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**





## Neni 8

### Organi Vendimmarrës

Ortaku i vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë. Ortaku i vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku vendos për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim , përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 9

### Administrimi

Administrator i shoqërisë "ANG-OLI" sh.p.k , caktohet Z. Angelo Olivia, i cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm themelues të shoqërisë.

## Neni 10

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.



- b) Përfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqësin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raportoi përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e Asamblesë në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojn ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Administratori/et, së bashku edhe vecas njëri-tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### Neni 11

#### Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet në 31 dhjetor.

### Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”
- e) me vendim të Gjykatës

Në këtë rast Asamblea merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

### **Neni 13**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjiit “Për tregtarët dhe Shoqërit tregtare”, Kodit Civil dhe cfarë do ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 14**

#### **Dispozita përfundimtare**

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale .

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**

**Angelo OLIVA**

*Angelo Oliva*

